

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, në çështjen juridike të paditësve R.G. dhe B.H., komuna e Lipjanit, të cilët i përfaqëson avokati N.G., nga Lipjani, kundër të paditurës K.S. “S” në Prishtinë, për dëmshpërblim, përkitazi me revizionin e paditësve, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.561/13, datë 11.01.2016, në seancën e mbajtur më 5.04. 2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Refuzohet si i pathemeltë revizioni i paditësit të parë, paraqitur kundër pjesën I të dispozitivit aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Prishtinë, Ac.nr.561/13, datë 11.01.2016, që ka të bëjë me shpërblimin e dëmit për dhimbjet fizike - në shumën prej 3500€, për frikë – 2500 €, për shëmtim - 3000€, ndërsa pranohet revizioni i paditësit të parë, në pjesën që ka të bëjë me shpërblimin e dëmit për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetëso, lidhur me të cilën NDRYSHOHEN aktgjykimi i sipërpërmendur dhe ai i Gjykatës Komunale Lipjan, C.nr.55/12, datë 5.11.2012, ashtu që detyrohet e paditura t’ia paguajë paditësit të parë, në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, shumën prej 9000 €.

II. Refuzohet si i pathemeltë revizioni i paditësit të dytë, paraqitur kundër pjesës I të dispozitivit të të njëjtit aktgjykim të gjykatës së shkallës së dytë, që ka të bëjë me shpërblimin e dëmit jomaterial për dhimbjet fizike në shumën prej 1000 € dhe për frikën e përjetuar në shumën prej 800 €.

III. Aktgjykimet e sipërpërmendura NDRYSHOHEN përkitazi me kamatën, ashtu që detyrohet e paditura që, mbi shumat e miratuara, të paguajë kamatën sipas normës së interesit, të cilën e paguajnë bankat vendore për mjetet e afatizuara për një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 5.11.2012, si ditë e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë, deri në pagesën përfundimtare.

IV. Pjesa e I e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë dhe aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, që ka të bëjë me paditësin e dytë, përkitazi me shpërblimin e dëmit

material për kujdesin dhe ndihmën e një personi të tretë si dhe për ushqimin e përforcuar, mbetet e pashqyrtuar.

A r s y e t i m i

Me pjesën I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.561/13, datë 11.01.2016, është ndryshuar pjesa I e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Komonale Lipjan, C.nr.55/12, datë 5.11.2012, dhe është detyruar e paditura që, në emër të kompensimit të dëmit jomaterial të pësuar si pasojë e aksidentit në trafik që ka ndodhur në datën 3.01.2006, paditësit të parë t'i paguajë: për dhimbjet fizike - shumën prej 3500€, për frikën e përjetuar - 2500€, për zvogëlim të aktivitetit jetësor – 6000 €, për shëmtim - 3000€ ose shumën e përgjithshme prej 15.000€, ndërsa për shumën përtej shumës së aprovuar kërkesëpadia e paditësit është refuzuar si e pathemeltë. Ndërkaq, është prishur pjesa I e dispozitivit të aktgjykimit ankimor, që ka të bëjë me shpërblimin e dëmit material nga e paditura ndaj paditësit të parë për kujdesin dhe ndihmën e një personi të tretë, ushqimin e përforcuar, shpenzimet e mjekimit, zvogëlimin e aftësisë për punë dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim. Është ndryshuar 1.2) i aktgjykimit të goditur, ashtu që është detyruar e paditura që paditësit të dytë t'ia shpërblejë dëmin për dhimbjet fizike të përjetuar në shumë prej 1000€ dhe për frikën e përjetuar në shumën prej 800€, ndërsa për pjesën përtej shumës së aprovuar, kërkesëpadia është refuzuar si e pabazuar, kurse për dëmin material, në emër të ndihmës nga personi i tretë dhe ushqimit të përforcuar, është vërtetuar. E paditura është detyruar që mbi shumat e aprovuara të paguajë kamatën sipas normës së interesit që paguhet për mjetet e depozituara për kursim mbi një vit, pa destinim të caktuar, e cila llogaritet nga datë 17.04.2007 deri në pagesën përfundimtare, ndërkaq është prishur vendimi i aktgjykimit të goditur që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësit, kanë paraqit revizion brenda afatit ligjor, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet revizioni, të ndryshohet aktgjykimi i goditur në favor të paditësve, duke vërtetuar atë të shkallës së parë sa u përket shumave të aprovuara, rentës për zvogëlim të aftësisë për punë në formë të kapitalizuar, kamatës dhe shpenzimeve të procedurës për të dy paditësit, ose ai të priset dhe lënda të kthehet për rigjykim në bazë të nenit 223.1, nenit 224.1 e 2 të LPK.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimit të goditur në pajtim me nenin 215 të LPK, konstatoi:

Revizioni është pjesërisht i themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se në datën 3.01.2006, në rrugën Lipjan – Janjevë, ka ndodhur një aksident trafiku, shkaktuar nga lëshimet e drejtuesit të veturës "M", me targa... e siguruar tek e paditura e që drejtohej nga R.A., i cili është shpallur fajtor me aktgjykimin P.nr.104/06, dat 30.05.2006, të Gjykatës Komunale Lipjan. Në këtë aksident lëndime të rënda trupore ka pësuar paditësi i parë, R.G., (si pasagjer) nga ..., kurse lëndime të lehta trupore kishte pësuar paditësi i dytë, B.H., (si pasagjer). Paditësi i parë, si rast urgjent, është dërguar në QKUK të Prishtinës, ku i bëhet ekzaminimi klinik, radiologjik dhe laboratorik dhe konstatohen: gjakderdhje kraniale, thyerje të brinjëve 4,5 dhe 7 të majtë si dhe lëndim i ligamenteve të gjurit të djathtë. Paditësi i parë ka pasur dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të lartë - 2 orë, të lartë - 72 orë, të mesëm - 2 javë, të ulët - 8 javë, por të pranishme kohë pas kohe edhe më pas. Ai ka zvogëlim të aktivitetit jetësor në shkallën prej 30% që manifestohet me dhimbje të kohëpaskohshme të kokës, harresë, dislokim të gjurit të djathtë për shkak të lëndimit të aparatit ligamentar gjatë lëvizjeve të pakontrolluara të gjurit, hipotrofi të muskujve të gjymtyrës së poshtme të djathtë; po ashtu, shëmtim të shkallës së mesme (5-7), që manifestohet me çalim në këmbën e djathtë dhe i duhet ta përdorë bastunin; përkujdesja nga një personi i tretë ka qenë e domosdoshme për tre muaj; ushqimi i përforcuar 6 muaj; terapia dhe rahabilitimi i domosdoshëm në ndonjë qendër rehabilituese në të ardhmen për dy vjet radhazi, nga tri javë. Ky paditës ka përjetuar frikë sekondare të një intensiteti të lartë nga momenti i rikthimit të plotë të vetëdijes, e cila ka zgjatur për dy ditë, shoqëruar nga një gjendje ankthi dhe pagjumësie, duke kaluar pastaj në frikë sekondare të një intensiteti më të ulët, e cila ka zgjatur tre muaj, shoqëruar me nervozë, shqetësime gjatë gjumit, pasiguri të pjesëmarrjes në trafik. Ndërkaq, paditësi i dytë kishte pësua gërvishtje dhe kontuzion të femurit të djathtë dhe gjurit të djathtë, me dhimbje fizike në momentin e lëndimit të intensitetit posaçërisht të lartë, që kanë zgjatur dy orë, të lartë - 6 orë, të mesëm edhe për 10 ditë. Përkujdesja dhe ndihma e një personi të tretë ishte e nevojshme 10 ditë, ushqim i përforcuar - 10 ditë; ai ka përjetuar frikë sekondare të një intensiteti të lartë - dy orë, shoqëruar me frikë nga invaliditeti i përhershëm, pastaj ka kaluar në frikë sekondare të një intensiteti më të ulët që ka zgjatur për rreth një muaj, shoqëruar kjo me pasiguri gjatë pjesëmarrjes në komunikacion dhe shqetësime të herëpashershme gjatë gjumit.

Në bazë të kësaj gjendje faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë e ka miratuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit dhe ka vendosur si në pjesët I, II dhe III të dispozitivit të aktgjykimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë, duke vepruar në procedurën ankimore, e ka pranuar pjesërisht ankesën e së paditurës dhe e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë lidhur me paditësin e parë, përkritazi me shpërblimin e dëmit për dhimbje fizike, frikë, zvogëlim të aktivitetit jetësor dhe e ka prishur përkritazi me dëmin material për kujdesin dhe ndihmën e një personi të tretë, ushqimin e përforcuar, shpenzimet e mjekimit, zvogëlimin e aftësisë për punë (dhe për shpenzimet e procedurës), duke e kthyer lëndën për rigjykim. Po ashtu, të njëjtin aktgjykim e ka ndryshuar lidhur me paditësin e dytë për sa i përket shpërblimin e dëmit jo material në emër të dhimbjeve fizike dhe frikën e përjetuar, ndërsa e ka vërtetuar për sa i përket dëmit material, në emër të ndihmës nga një person i tretë dhe ushqimit të përforcuar, me kamatë mbi shumat e aprovuara nga data 17.04.200, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Nisur nga kjo gjendje të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së dytë i ka zbatuar drejt dhe në mënyrë të plotë dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, duke ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë në pjesën që ka të bëjë me shpërblimin e dëmit jo material ndaj paditësit të parë, për sa u përket dhimbjeve fizike, frikës së përjetuar dhe shëmtimit dhe ndaj paditësit të dytë, në pjesën që ka të bëjë me dëmin jo material për dhimbjet fizike dhe frikën e përjetuar. Lidhur me sa u tha më sipër janë dhënë arsye të mjaftueshme, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë. Shumat e aprovuara janë në përputhje me karakterin e shpërblimit të këtyre llojeve të dëmit dhe në përpjesëtim me shkallën dhe natyrën e lëndimeve të pësuar, intensitetin dhe kohëzgjatjen e tyre. Me rastin e caktimit të shumave të shpërblimit të formave të caktuara të dëmit jo material, gjykata, sipas nenit 200 të LMD, duhet të kujdeset për rëndësinë e së mirës së dëmtuar dhe qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim. Duke i pasur parasysh kriteret e parashikuara në këtë dispozitë ligjore, rëndësinë e vlerave të dëmtuara të paditësve, sikurse edhe standardin jetësor të qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe praktikën gjyqësore, shumat e caktuara të shpërblimit të dëmit ndaj paditësit janë adekuate, ekuivalente dhe në përputhje me natyrën, peshën dhe shkallën e lëndimeve të pësuar, të cilat nuk kanë qëllim fitimprurës, por rivendosjen e ekuilibrit psikik të rrënuar te paditësit dhe duhet të shërbejnë si një satisfaksion për ta, prandaj, për arsyet e sipërpërmendura, nuk qëndrojnë thëniet e paraqitura në revizion sipas së cilave shumat e aprovuara për llojet e përmendura të dëmit janë të ulëta dhe jo adekuate.

Përcaktimi i shpërblimit të dëmit jo material paraqet zbatim të së drejtës materiale, ndërsa, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, shuma e aprovuar e shpërblimit të dëmit në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor për paditësin e parë (30% -12.000€ - nga gjykata e shkallës së parë dhe 6000 € - nga gjykata e shkallës së dytë) nuk është në përputhje me kriteret e parashikuara në dispozitat e nenit 200.2 të LMD dhe me praktikën gjyqësore, për të cilën arsye aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta në këtë pjesë janë marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ndaj kjo Gjykatë, sipas nenit 224 të LPK, u desh t'i ndryshojë, duke detyruar të paditurën që paditësit të parë t'i paguajë, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shumën prej 9000 €, si shumë të cilën kjo gjykatë e vlerësoi të përputhur me natyrën dhe shkallën e këtij lloji të dëmit. Po ashtu, aktgjykimet e përmendura u ndryshuan edhe përkitazi me kamatën, e cila, konform nenit 277 të LMD, duhet të rrjedhë nga datë 5.11.2012, si datë e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, duke u vendosur si në pjesët I dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Për sa u përket pretendimeve të tjera të ngritura në revizion përkitazi me pjesën e prishur të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nga ana e gjykata e shkallës së dytë, Gjykata Supreme e Kosovës vlerësoi se kjo pjesë nuk mund të ishte objekt shqyrtimi me revizion (si mjet i jashtëzakonshëm juridik), sepse lënda lidhur me këtë pjesë i është kthyer për rigjykim gjykatës së shkallës së parë dhe prandaj në këtë drejtim nuk ka vendim të formës së prerë.

Pjesa I e dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së dytë dhe aktgjykimit të shkallës së parë që ka të bëjë me paditësin e dytë, përkitazi me shpërblimin e dëmit material për kujdesin dhe ndihmën nga një person i tretë dhe ushqimin e përforcuar, mbetet e pashqyrtuar, ngase nuk është goditur me revizion.

Nga sa u theksua më lart dhe sipas dispozitës së nenit 222 dhe nenit 224.1 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Rev.nr.76/2016 datë 5.04. 2016

Kryetari kolegjit

Mr.Sc.Muhamet Rexha
